

VENDIM
Nr. 112, datë 8.7.2016

PËR PËRCAKTIMIN E TË LICENCUARIT TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR USHTRIMIN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL

Në mbështetje të neneve 16; 19; 47; 83 dhe 85 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal, si dhe kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal, konstatoi se:

- ERE, në mbështetje të neneve 19, germa “d” dhe 83 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendos ndaj të licencuarve detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, në përputhje me parashikimet e neneve 47 dhe 85 të ligjit, sipas kushteve të përcaktuara nga ERE.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, ka miratuar “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcakton në nenet 2 dhe 4: “Detyrimi i shërbimit publik ndaj një të licencuari vendoset nga ERE”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Detyrimi i shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike i vendoset shoqërisë OSHEE sh.a./FSHU, sipas përcaktimeve të nenit 83, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe kushteve të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kushtet për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike bashkëlidhur këtij vendimi përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për të siguruar përmbushjen e detyrimit të shërbimit universal të energjisë elektrike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti